



# DHJETË TË ARRATISURIT MË TË KËRKUAR NGA FBI-JA

## RUJA IGNATOVA

**Komplot për të kryer transferim fallco parash, transferim fallco parash; Komplot për të kryer pastrim parash; Komplot për të kryer mashtrim të sikuracioneve; Mashtrim i sikuracioneve**



### PËRSHKRIMI

**Pseudonimet:** Dr. Ruja Ignatova, Ruja Plamenova Ignatova, Ruja P. Ignatova, "KriptoQueen"

**Data(t) e lindjes e përdorur:** 30 Maj, 1980

**Vendi i lindjes:** Bullgari

**Flokët:** Ngjyrë kafe ose të zeza

**Sytë:** Kafe

**Gjinia:** Femërore

**Raca:** E bardhë

**Gjuhët:** Anglisht, Gjermanisht, Bullgarisht

### SHPËRBLIM

**FBI-ja ofron një shpërblim deri në 100,000 dollarë për informacionin, i cili do të shpjerë në arrestimin e Ruja Ignatovës.**

### VËREJTJE

Ignatova besohet të udhëtojë e shoqëruar me roje të armatosura dhe/ose bashkëpunëtorë. Ignatova mund të ketë bërë ndërhyrje plastike ose të ketë ndryshuar pamjen e saj.

### KUJDES

Ruja Ignatova kërkohet për pjesëmarrjen e saj të dyshuar në një skemë mashtruese në shkallë të gjërë. Duke filluar nga afërsisht viti 2014, Ignatova dhe të tjerë dyshohet se kanë mashtruar miliarda investitorë në të gjithë botën me shumë prej miliarda dollarësh. Ignatova ka qenë themeluese e OneCoin Ltd., një ndërmarrje me qendër në Bullgari, e cila nxorri në treg të ashtuquajtura kriptomonedha. Në mënyrë që të realizonte skemën e saj, Ignatova bëri deklarata dhe përfaqësime të rreme ndaj individëve, në mënyrë që të siguronte investime për në OneCoin. Thuhet se ajo instrukttoi viktimat të dërgonin fonde investimi në llogaritë e OneCoin, me qëllim që të blinin paketat e OneCoin, duke i bërë viktimat të dërgonin transferata monetare, të cilat përfaqësonin këto investime. Besohet se gjatë të gjithë skemës, OneNote ka mashtruar viktimat me një shumë prej më se 4 miliardë dollarë.

Ignatova shërbeu si drejtuesja kryesore e OneCoin deri në tetor të vitit 2017. Më 25 tetor 2017, Ignatova udhëtoi nga Sofia, Bullgari, për në Athinë, Greqi, dhe pas këtij udhëtimi mund të ketë udhëtuar edhe më tej. Ajo mund të përdorë një pasaportë gjermane për të udhëtuar për në Emiratet e Bashkuara Arabe, Bullgari, Gjermani, Rusi, Greqi dhe/ose në Europën Lindore.

Më 12 Tetor 2017, Ignatova u akuzua nga Gjykata e Qarkut të Shteteve të Bashkuara, Qarkun Jugor i Nju Jorkut, e cila nxorri një urdhër federal arresti për arrestimin e saj. Më 6 Shkurt 2018, Ignatova u akuzua për komplot për të kryer transferim fallco parash; transferim fallco parash, komplot për të kryer pastrim parash, komplot për mashtrim të sikuracioneve, dhe mashtrim të sikuracioneve.

**Nëse keni ndonjë informacion në lidhje me këtë person, ju lutemi kontaktoni zyrën tuaj lokale të FBI-së ose Ambasadën apo Konsullatën më të afërt amerikane.**

**Zyra Lokale e FBI-së:** New York